

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist Help Desk** pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit.

SPECIALIST

Të sigurojë funksionimin optimal, të qëndrueshëm dhe të sigurt të infrastrukturës së rrjetit kompjuterik dhe komunikimit të të dhënave në organizatë. Të kujdeset për mirëmbajtjen, përditësimin dhe monitorimin e të gjitha pajisjeve dhe shërbimeve të rrjetit.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Projektimi, implementimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve LAN/WAN/Wi-Fi.
- Konfigurimi dhe administrimi i pajisjeve të rrjetit: switch, router, firewall, access point, etj.
- Monitorimi i performancës së rrjetit dhe identifikimi i problemeve të mundshme.
- Menaxhimi i sigurisë së rrjetit përmes politikave të aksesit, VPN-ve, NAT, filtrimit të trafikut, dhe zbatimit të standardeve të sigurisë.
- Mbajtja e dokumentacionit teknik për topologjinë e rrjetit, konfigurimet, dhe ndryshimet.
- Bashkëpunimi me ekipin e sigurisë dhe zhvillimit për integrimin e sistemeve të reja në rrjet.
- Trajtimi i incidenteve dhe ndihma teknike për stafin në rast ndërprerjesh të rrjetit apo problemeve të lidhjes.
- Pjesëmarrja në projektet për përmirësimin e infrastrukturës IT dhe digjitalizimin e proceseve.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë e nivelit Bachelor ose Master në Inxhinieri Elektronike/Telekomunikacioni, Teknologji Informacioni, apo fusha të ngjashme.
- Minimumi 2-3 vite përvojë në administrimin e rrjeteve kompjuterike.
- Njohuri të thella në TCP/IP, DHCP, DNS, VLAN, VPN, routing protocols (OSPF, BGP).
- Eksperiencë me pajisje të markave si Cisco, HP, Fortinet etj.

- Preferohet certifikimi: CCNA, CCNP, CompTIA Network+, ose ekuivalent.
- Aftësi të mira në dokumentim teknik dhe përdorimin e mjeteve të monitorimit.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip, nën presion dhe me afate kohore.

Aftësi të dëshirueshme:

- Njohuri bazike në fushën e sigurisë kibernetike.
- Aftësi të mira komunikuese dhe për zgjidhjen e problemeve.
- Qasje analitike dhe përqëndrim në detaje.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.